



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 93

Tiranë – E hënë, 4 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 82, datë 24.4.2026	Për delegimin e kompetencës zëvendësministrit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Qendra për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë” dhe disa rregulla për zbatimin e saj..... 8379
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 118, datë 23.4.2026	Për miratimin e Planit të Veprimit të Dokumentit të Politikave të Arsimit të Lartë 2030..... 8379
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 19.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 529 (2595), datë 25.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 1482 (4042), datë 29.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 282, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-1437, datë 12.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimin e çdo veprimi përmbartimor ose administrativ mbi pasurinë e konfiskuar, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, së drejtës së pronës dhe së drejtës për ankim efektiv të shtetasve Frederik Derza, Violeta Rreshpja dhe Gjovalin Rreshpja. Përcaktimin e organit kompetent gjyqësor për trajtimin e pretendimeve të shtetasve Frederik Derza, Violeta Rreshpja dhe Gjovalin Rreshpja, për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, së drejtës së pronës dhe së drejtës për ankim efektiv..... 8381
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 190/12, datë 28.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Urës së fshatit Metoq”, Bashkia Sarandë..... 8395

**URDHËR****Nr. 82, datë 24.4.2026**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS
ZËVENDËSMINISTRIT PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNITIT ME KORPORATËN E
INVESTIMEVE SHQIPTARE, NË
KUADËR TË PROJEKTIT TË
INVESTIMIT “QENDRA PËR
ZHVILLIMIN MULTIFUNKSIONAL,
TIRANË” DHE DISA RREGULLA PËR
ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 11, të pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar; si dhe të vendimit nr. 119, datë 27.2.2026, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit ‘Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore’, me nënprojektet si ‘Korpusi i institucioneve të pavarura’, ‘Qendra për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Partnerit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Qendra për Zhvillimin Multifunksional, Tiranë”.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në inventarin e së cilës ndodhen pronat që transferohen sipas marrëveshjes, të ndjekë realizimin e procedurave për vënien në dispozicion dhe dorëzimin e pronave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes dhe legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e

përfituesve kryesorë nga projekti i investimit, të bashkëpunojnë me Korporatën e Investimeve Shqiptare dhe të ndjekin procedurat e tjera në zbatim të detyrimeve të parashikuara në marrëveshje, përfshirë përcaktimin e nevojave dhe specifikimeve teknike, lidhur me projektin.

4. Ngarkohen zëvendësministri i Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Punëve të Brendshme për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

URDHËR**Nr. 118, datë 23.4.2026**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT TË DOKUMENTIT TË
POLITIKAVE TË ARSIMIT
TË LARTË 2030**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të urdhrit nr. 109, datë 12.03.2025, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Arsimit të Lartë 2030”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit të Dokumentit të Politikave të Arsimit të Lartë 2030, sipas tekstit bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia e Sigurimit të



Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve
Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

Nr.	Aktiviteti	Afati	Përgjegjës	Njësia	Sa si a	Kosto/ njësi (EUR)	Kostoja totale (EUR)	Kostoja totale (LEK)	Buxh. 2025 - '27 (LEK)	PBA 2026-28 (LEK)	Metodologjia e llogaritjes/ shënime	Statusi
											100	
QËLLIMI 1: Arsimi i lartë, faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, përmes ofertës akademike bashkëkohore, në përshtatje me nevojat e shoqërisë dhe kërkesat dinamike të tregut të punës, për të pajisur studentët me aftësitë e së ardhmes dhe duke synuar rritjen e produktivitetit												
Obj. 1.1: Përmirësimi i ofertës akademike												
1	Rishikimi i ligjit 80/2015, për arsimin e lartë	Dhjetor 2026	MA	grup pune + takim konsultimi	1	19,500	19,500	1,950,000			1 grup pune ligjore + 1 konsultim publik	Vlerësim
2	Rishikimi i programeve ekzistuese + kurrikula të reja (STEM, digital, turizëm)	24 muaj	Komisioni Kurrikulës / IAL / MA	ekspert/ muaj	15	3,000	45,000	4,500,000			Ekspert kurrikule 3 000 EUR/ muaj × 15 muaj	Vlerësim
3	Programe ndërdisiplinore	2027	IAL / MA	program	4	6,000	24,000	2,400,000			4 programe × 6 000 EUR (dizajn + pilotim)	Vlerësim
4	Vlerësimi i cilësisë – pyetësorë studentë, Alumni, biznese	Vjetor	ASCAL / MA	survey/ vit	1	5,000	5,000	500,000			Sallë, materiale, moderator, ~50 pjesëmarrës	Vlerësim
5	Rishikimi i formulës së financimit të IAL-ve (performancë)	2026	AKFAL / MA	studim	1	8,000	8,000	800,000			Konsulencë + dokumentim formula financimi	Vlerësim
6	Rishikim kuadri ligjor – konkurrencë dhe llogaridhënie	Qershor 2026	MA	raport ligjor	1	5,000	5,000	500,000			Draftligjor + konsultim publik	Vlerësim
7	Studim bashkimi/profilizimi IAL-ve	Qershor 2027	MA / IAL	studim	1	8,000	8,000	800,000			Kërkime, konsulencë, raport final	Vlerësim
Obj. 1.2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës												
1	Fuqizimi i zyrave të karrierës – 1 zyrë / IAL	2 vjet	IAL / MA	zyrë/ muaj	12	4,000	48,000	4,800,000			Staf + materiale orientimi 4 000 EUR/ muaj × 12 muaj	Vlerësim
2	Bashkëpunim sektor privat – praktika/internshipe (4 workshope)	2 vjet	IAL / Dhoma Tregtisë / MA	workshop	4	50,000	200,000	20,000,000	0	20,000,000	4 workshope × 50 000 EUR (kosto zyrtare)	Buxheti i AKKSHI-t
3	Profilizimi i IAL-ve rajonale	2027	MA / Senatet Akademike	ekspert/ muaj	12	3,000	36,000	3,600,000			Analizë nevojash rajonale + dokumentim 3 000/ muaj × 12	Vlerësim
QËLLIMI 2: Reformat EHEA/ERA – Ndërkombëtarizimi dhe cilësia												
Obj. 2.1: Cilësia e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor/ Totali zyrtar: 180 000 EUR/18 000 000 lekë												
1	Marrëveshje ndërkombëtare, filialet, programe të përbashkëta	36 muaj	Zyra Ndërkombëtare/IAL/MA	marrëveshje	4	5,000	20,000	2,000,000			4 marrëveshje × 5 000 EUR (negocim + dokumentim)	Vlerësim
2	Projekti “Strategjia UBT 2030”	4 vite	UBT	projekt	1	1,950,000	1,950,000	195,000,000	0	0	Projekt i aprovuar UBT – kosto zyrtare totale	Buxheti 2025–2027
3	Infrastruktura arsimore – Kolegji i Evropës	Deri 2028	FSHZH / MA/Bashkia Tiranë	objekt	1						Δ Kostoja infrastrukturorë – vlerësim i detajuar i nevojshëm	Δ Kostoja e lartë
4	Kapacitete stafi – fonde ndërkombëtare (Erasmus+ Horizon)	Vazhdimësi	AKKSHI	aplikim/ vit	2	5,000	10,000	1,000,000			2 aplikime/ vit × 5 000 EUR (konsulencë + kosto aplikimi)	Vlerësim
5	Partneritete me sektorin privat për bashkëfinancim	2026	Zyra Transferimit / Dhomat	partneritet	3	5,000	15,000	1,500,000			3 partneritete × 5 000 EUR (negocim + marrëveshje)	Vlerësim
6	Financimi i 60 doktoraturave (deri 2028)	2028	AKKSHI / MA	doktoraturë	60	3,000	180,000	18,000,000	0	18,000,000	60 bursa × 3 000 EUR/ vit (kosto zyrtare)	Buxheti i AKKSHI-it
7	Kurse inovacioni – 1 rajonal + 1 kombëtar/vit	Vazhdimësi	IAL / AKKSHI	konkurs/ vit	2	5,500	11,000	1,100,000			2 konkurse/ vit × 5 500 EUR (çmime + organizim + media)	Vlerësim
8	Trajnim kompetenca digjitale – staf dhe studentë	Vazhdimësi	Fakultetet / IAL	person	20	1,200	24,000	2,400,000			~20 persona × 1 200 EUR (trajnim + materiale + certifikim)	Vlerësim
9	Infrastrukturë digjitale ACRI	Qershor 2027	MA / AKSHI / AKKSHI	sistem	1				200,000,000	0	200 000 000 LEK – kosto zyrtare (buxhet)	Buxheti 2025
10	Aktet nënligjore – zbatim i ligjit për shkencën	Mars 2026	MA	akt nënligjor	3	5,000	15,000	1,500,000			3 akte × 5 000 EUR (konsulencë ligjore + konsultim)	Vlerësim
11	Rankime ndërkombëtare – të paktën 4 IAL	Dhjetor 2026	AKKSHI	LAL	4	2,500	10,000	1,000,000			4 LAL × 2 500 EUR (tarifë rankimi + raportim)	Vlerësim
Obj. 2.2: Arsimi i lartë si katalizator zhvillimi social e digjital/ Totali zyrtar: 8 270 000 EUR/827 000 000 LEK												



1	Kurse ekstra-kurrikulare (komunikim, prezantim, administrim)	24 muaj	IAL / MA	kurs	6	3,000	18,000	1,800,000			6 kurse × 3 000 EUR (trajnes + materiale)	Vlerësim
2	Bashkëpunim diaspora akademike – Programi READ	24 muaj	AKKSHI / MA / IAL	projekt	1	1,250,000	1,250,000	125,000,000	0	125,000,000	Programi READ – kostoja zyrtare e aprovuar	Buxheti i AKKSHI-t
3	Prezenca IAL-ve në parqe teknologjike	24 muaj	Ministritë / IAL / Bashkitë	LAL	4	6,000	24,000	2,400,000			4 LAL × 6 000 EUR (studim + koordinim + pilot)	Vlerësim
4	Module zhvillim i qëndrueshëm + qytetari aktive	2026–2027	Fakultetet / IAL	modul	4	6,000	24,000	2,400,000			4 module × 6 000 EUR (dizajn + pilotim + materiale)	Vlerësim
5	Bursat – barazi dhe përfshirja sociale	Vazhdim çsi	IAL / MA	bursë/vit	1	7,020,000	7,020,000	702,000,000	702,000,000	0	Buxheti 2025-27: 702 000 000 LEK –	Buxheti i AKKSHI-t
6	Pavarësia e ASCAL – ndryshime ligjore (ESG)	2027	ASCAL / MA	draft ligjor	1	6,000	6,000	600,000			1 draft ligjor (konsulencë + konsultim publik)	Vlerësim
7	Mekanizma sigurimi cilësie – përditësim	Dhjetor 2026	ASCAL	raport + trajnim	1	5,000	5,000	500,000			Ekspertë + dokumentim + 1 sesion trajnimi ASCAL	Vlerësim
TOTALI –							10,980,500	1,098,050,000				

Shënim. Konvertimi nga euro në lekë është kryer duke marrë kursin e këmbimit 1 euro=100 lekë

Përlogaritjet janë kryer bazuar në vlerësime dhe tarifatat e aplikuar në projekte të BE-së, BB-së dhe aktivitete të ngjashme, por këto tarifa nuk janë përfundimtare, por vetëm për efekt përlogaritjeje dhe kostimi.

VENDIM Nr. 36, datë 19.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji kryetare;
Marsida Xhaferllari anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimimi anëtar;
Marjana Semini anëtare;
Asim Vokshi anëtar;
Sonila Bejtja anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datat 4.12.2025, 22.12.2025 dhe 11.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (A) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Antonela Derza, Federik Derza, Violeta Rreshpja, Gjovalin Rreshpja, përfaqësuar nga avokati Gerti Ymeri, me prokurë

SUBJEKTE TË INTERESUARA

Prokuroria E Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Alfred Progonati, me autorizim.

Gjergj Shtogaj, Age Shtogaj, përfaqësuar nga avokati Gëzim Pjetraj, me prokurë.

Aleksandër Kocaj

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 529 (2595), datë 25.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 1482 (4042), datë 29.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 282, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.

00-2024-1437, datë 12.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i çdo veprimi përmbarimor ose administrativ mbi pasurinë e konfiskuar, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt, së drejtës së pronës dhe së drejtës për ankim efektiv të shtetasve Frederik Derza, Violeta Rreshpja dhe Gjovalin Rreshpja.

Përcaktimi i organit kompetent gjyqësor për trajtimin e pretendimeve të shtetasve Frederik Derza, Violeta Rreshpja dhe Gjovalin Rreshpja, për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, së drejtës së pronës dhe së drejtës për ankim efektiv.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 31, 33, 41, 42, 43, 124, 131, pikat 1, shkronja “f” dhe 2, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; neni 5 i Konventës Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”; nenet 27, 71, 71/a, 72 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, Antonela Derza, Federik Derza, Violeta Rreshpja,



Gjovalin Rrepshja (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme, Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit të interesuar Aleksandër Kocaj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 38, datë 17.4.2001 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së*), Malësi e Madhe, rezulton se shtetasi Z.K. është njohur pronar i një sipërfaqeje prej 10.000 (dhjetë mijë) m². Mbi bazën e këtij vendimi, në datën 16.3.2004, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Malësi e Madhe është kryer regjistrimi fillestar i pasurisë me nr. 221/2, me sipërfaqe 10.000 m² të ndodhur në Zonën Kadastrale (ZK) 3834, në pronësi të shtetasi L.K. (djali i shtetasi Z.K. dhe babai i kërkueses Antonela Derza).

2. Mbi këtë pasuri rezulton se janë kryer dy shitblerje. E para shitblerje është kryer në vitin 2012 ndërmjet babait të kërkueses Antonela Derza, shtetasi L.K. dhe kërkuesit Federik Derza, ndërsa shitblerja e dytë është kryer në vitin 2015 ndërmjet kërkuesit Federik Derza dhe kërkuesve të tjerë Gjovalin Repshja dhe Violeta Repshja, për një sipërfaqe toke 700 m². E gjithë pasuria tashmë nga transaksionet e kryera ka marrë numërtim tjetër, duke u ndarë në tri parcela 221/4, 221/5 dhe 221/6 në ZK 3834. Parcela e parë është në pronësi të kërkuesve Gjovalin Rrepshja dhe Violeta Rrepshja, ndërsa dy parcelat e tjera janë në pronësi të kërkuesit Federik Derza. Po ashtu, rezulton se shtetasi L.K., babai i kërkueses Antonela Derza, i datëlindjes 28.8.1929, ka vdekur në datën 26.6.2018, vërtetuar kjo sipas certifikatës së datës 19.6.2019.

3. Mbi bazën e kallëzimit të bërë nga disa shtetas, të cilët kanë pretenduar se janë banorë të vjetër të fshatit Vrih/Razëm, njësia administrative Shkrel dhe se kërkuesja Antonela Kçira/Derza po mundohej të merrte një sipërfaqe toke 10.000 m² në fshatin Razëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria e Shkodrës*) ka

regjistruar procedimin penal nr. 1203 të vitit 2017, në ngarkim të shtetasi L.K., babai i kërkueses Antonela Derza, për akuzat e kryerjes së veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 287 të Kodit Penal (KP). Për këtë arsye, nga ana e Prokurorisë së Shkodrës është paraqitur një kërkesë me anë të së cilës kërkohej të vendosej sekuestroja preventive për këto pasuri të paluajtshme, pasi dyshohej se ishin marrë (fituar) dhe shitur pjesërisht, duke u përdorur një dokument i falsifikuar, si dhe duke u pastruar produktet e kësaj vepre penale.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 529 (2595), datë 20.5.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Shkodrës për vënien e sekuestros preventive për pasuritë e llojit “livadh”, me nr. 221/4, me sipërfaqe 700 m², të regjistruar në datën 19.2.2015 në emër të Gjovalin Rrepshjes dhe Violeta Rrepshjes, nr. 221/5, me sipërfaqe 8800 m² e nr. 221/6, me sipërfaqe 500 m², të regjistruara në datën 19.2.2015 në emër të Federik Derzës, me arsyetimin se ajo është e bazuar në ligj dhe përpunet me qëllimin e përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ky vendim rezulton se nuk është ankimuar dhe është ekzekutuar me urdhrin e prokurorit të datës 28.5.2018.

5. Në vijim të hetimeve të procedimit penal, Prokuroria e Shkodrës ka konstatuar se ndjekja penale për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së është parashkruar, ndërsa për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndjekja penale nuk mund të vazhdojë më, pasi shtetasi i dyshuar L.K. ka vdekur. Për rrjedhojë, sipas Prokurorisë së Shkodrës, procedimi penal për këto vepra duhej pushuar, pasi ndjekja penale nuk mund të vazhdonte më. Për këtë arsye, Prokuroria e Shkodrës i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pushimin e procedimit penal, si dhe konfiskimin e pasurive të sipërpërmendura dhe asgjësimin e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe, i cili pretendonte se ishte falsifikuar.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1482 (4042), datë 29.7.2019, ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesën e Prokurorisë së Shkodrës, duke pushuar çështjen penale për procedimin penal nr. 1203 të vitit 2017



për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, pasi personi që dyshohej se kishte kryer veprën penale kishte vdekur dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, pasi ishte plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale. Për pjesën tjetër të kërkesës, për konfiskimin e pasurive të paluajtshme dhe asgjësimin e vendimit nr. 38/2001, të KKKP-së, Malësi e Madhe, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkimet e prokurorisë për konfiskimin e pasurive të paluajtshme janë pabazuara në ligj, për sa kohë u çmua se hetimet duhen pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe vdekjes të të dyshuarit dhe gjykata nuk i hyn fare faktit nëse vërtet vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së, Malësi e Madhe është i falsifikuar ose jo dhe pasuritë e përmendura në të janë produkt i veprave penale ose jo. Kështu, sipas asaj gjykate, personat e dëmtuar ose ata të interesuar çdo pretendim që lidhet me konstatimin e falsifikimit të një dokumenti ose me kthimin e pasurive të paluajtshme të përfituara me dokumente të falsifikuara duhet t’ia drejtojnë gjykatës ose çdo organi tjetër kompetent. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim Prokuroria e Shkodrës, duke kërkuar pranimin plotësisht të kërkesës së saj, pushimin e procedimit penal, asgjësimin e dokumentit të falsifikuar, si edhe konfiskimin e pasurive dhe kalimin e tyre në favor të shtetit.

7. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 282, datë 16.10.2019, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 1482 (4042), datë 29.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin që ka vendosur të pranojë plotësisht kërkesën e Prokurorisë së Shkodrës, duke vendosur asgjësimin e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe, si dhe konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të pasurive të llojit “livadh” nr. 221/4, me sipërfaqe 700 m², në emër të Gjovalin Rrepshjes dhe Violeta Rrepshjes, nr. 221/5, me sipërfaqe 8800 m² e nr. 221/6, me sipërfaqe 500 m², të regjistruara në emër të Federik Prel Derzës, me vendndodhje në fshatin Vrith, njësia administrative Shkrel, Malësi e Madhe. Sipas gjykatës së apelit, falsiteti tërësor i vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe provohet nga deklaratimet e shtetasve në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shkresat e institucioneve zyrtare, praktikat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pranë

ZVRPP-së, kontratat e shitblerjes dhe dokumentet e ZVRPP-së për ndarjen e pasurive. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuar Antonela Derza.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2024-1437, datë 12.9.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Në vlerësimin e Kolegjit Penal vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, brenda kufijve të shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprae.

9. Në datën 21.2.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuar i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 6.3.2025.

10. Kolegji i Gjykatës në datën 24.4.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke përcaktuar edhe subjektet e interesuara që do të thirrreshin në gjykim, të cilat janë njoftuar nga Gjykata për vendimmarrjen e Kolegjit.

11. Në datën 18.6.2025 Gjykata është njoftuar nga bashkëshortja e subjektit tjetër të interesuar, Aleksandër Kocaj, se ai ka ndërruar jetë në datën 19.4.2021. Për këtë arsye, Gjykata, në datën 24.6.2025, ka vënë në dijeni bashkëshorten e të ndjerit Aleksandër Kocaj se nëse kërkon të marrë pjesë si palë në këtë gjykim, në cilësinë e trashëgimtares, të paraqesë kopje të njëzuar me origjinalin të dëshmisë së trashëgimisë ligjore ose testamentare. Në vijim, nga bashkëshortja e të ndjerit nuk është paraqitur asnjë akt që shprehë vullnetin e saj për të marrë pjesë në këtë gjykim kushtetues.

12. Pas zhvillimit të seancës plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 4.12.2025, Gjykata ka deklaruar mbylljen e saj dhe tërheqjen e trupit gjykues për të marrë vendim. Duke vlerësuar se ishte i nevojshëm sqarimi i rrethanave plotësuese me rëndësi për çështjen, Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 44, pika 1, të Ligjit të saj Organik, në datën 22.12.2025 ka vendosur riçeljen e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, duke u kërkuar kërkuarve paraqitjen e argumenteve me shkrim, përfshirë edhe çdo provë relevante, në drejtim të disa aspekteve konkrete të gjykimit



kushtetues që kanë të bëjnë me legjitimitimin e tyre në gjykimin kushtetues. Në vijim, parashtrimet e paraqitura nga kërkuesit në këtë drejtim u janë komunikuar edhe subjekteve të interesuara.

13. Po ashtu, në argumentet shtesë të paraqitura nga kërkuesit pas riçeljes së seancës plenare, këta të fundit i kanë kërkuar Gjykatës edhe pezullimin e çdo veprimi përmbartimor ose administrativ për pasurinë e konfiskuar me vendimet objekt të këtij gjykimi kushtetues, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga Gjykata.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. Kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur kanë pretenduar:

i. Për legjitimitimin

14.1. Kërkuesja Antonela Derza legjitimohet *ratione personae*, pasi të drejtat e saj për pasurinë e konfiskuar burojnë për shkak të ligjit, si rrjedhojë e regjimit pasuror martesor të bashkësisë ligjore, pasi ajo është bashkëshortja e kërkuesit Federik Derza, i cili pronën e ka blerë nga babai i saj (shtetasi L.K.) në vitin 2012. Kërkuesit legjitimohen për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar dhe janë bartës të të drejtave themelore të cenuara nga procesi i kundërshtuar në këtë gjykim kushtetues.

14.2. Kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit organik të Gjykatës. Vendimi i Kolegjit Penal i kundërshtuar është publikuar i arsyetuar 15 ditë përpara paraqitjes së ankimit kushtetues. Për këtë arsye, pretendimi i subjekteve të interesuara Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj në këtë drejtim nuk është i bazuar.

14.3. Në lidhje me kriterin e legjitimitimit për *shterimin e mjeteve juridike efektive* për kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja, të cilët nuk kanë qenë pjesë e procesit hetimor dhe as atij gjyqësor, shqyrtimi i kërkesave të tyre në këtë gjykim buron nga shterimi i mjeteve të kërkueses tjetër Antonela Derza. Po ashtu, Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja kanë argumentuar se ata nuk kanë paraqitur rekurs, pasi nuk janë njoftuar asnjëherë personalisht nga organi i akuzës ose gjykatat për konfiskimin e pronës së tyre. Këta kërkues argumentojnë se edhe pse kanë

paraqitur shtesë rekursi, ai nuk është marrë në shqyrtim dhe as është përmendur në vendimin e Gjykatës së Lartë. Në vlerësimin e këtyre kërkuesve, nuk ka mjet tjetër efektiv përveç ankimit kushtetues. Kërkuesit kanë pretenduar edhe se nëse kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive, Gjykata duhet të përcaktojë kompetencën e organit gjyqësor që do të shqyrtojë në themel pretendimet e tyre.

ii. Për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

14.4. Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi i gjithë procesi gjyqësor, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, ka zgjatur rreth shtatë vjet, duke u tejkaluar të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e kësaj çështjeje, çka ka sjellë edhe cenim të së drejtës së pronës private. Edhe Kolegji Penal në gjykimin e çështjes nuk ka respektuar afatin njëvjeçar sipas nenit 399/2, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Edhe hetimet e zhvilluara nga organi i akuzës e kanë tejkaluar afatin e arsyeshëm, për pasojë kërkuesve u është sekuestruar prona.

14.5. Parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, si edhe së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi rifillimi i hetimeve të procedimit penal nr. 1203 të vitit 2017 nga Prokuroria e Shkodrës, për të njëjtin fakt dhe për të njëjtat rrethana, është bërë në kundërshtim me nenin 329/c të KPP-së. Rifillimi i hetimeve të procedimit penal nr. 1203 të vitit 2017 është bërë mbi bazën e kallëzimit të shtetasve Gjergj Shtogaj, Age Shtogaj dhe Aleksandër Kocaj, për të njëjtin fakt për të cilin, mbi kallëzimin e shtetasit Rr.Sh., kishte filluar në vitin 2006 procedimi penal nr. 781, i cili është pushuar në vitin 2007. Ky procedim ka nisur pa asnjë provë ose të dhënë të re dhe ky fakt tregon se një veprim i tillë është në shkelje të hapur të nenit 329/c të KPP-së. Organi i akuzës nuk duhet të regjistronte procedim penal të ri, por duhet të paraqiste në gjykatë kërkesën për revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 781 të vitit 2006. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me cenim të parimit të gjësë së gjykuar, siç ka prapësuar Prokuroria e Përgjithshme, por me cenim të subjektit procedural që lejon fillimin e hetimit.

14.6. Së drejtës për t’u dëgjuar, së drejtës së aksesit, së drejtës së ankimit efektiv dhe asaj për t’u njoftuar, si dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit në gjykim,



pasi i gjithë procesi hetimor dhe ai gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyimit është zhvilluar pa u thirrur asnjëherë kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rrephja dhe Violeta Rrephja, në emër të të cilëve ishte pasuria. Këta kërkues nuk kanë pasur dijeni për procedimin penal dhe nuk janë pyetur dhe nuk janë dëgjuar as gjatë hetimeve, as gjatë gjyimit në të gjitha shkallët. Ata nuk kanë pasur asnjë dijeni për procesin e zhvilluar për pasurinë e tyre.

14.7. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi me vendimin nr. 282, datë 16.10.2019 Gjykata e Apelit Shkodër ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 425 të KPP-së. Në ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë prokurori nuk ka kundërshtuar disponimin e asaj gjykate për pushimin e hetimit të procedimit penal dhe për më tepër nuk ka kërkuar që gjykata e apelit të analizojë faktin nëse vendimi i KKKP-së ishte ose jo i falsifikuar. Po ashtu, prokurori nuk ka kërkuar as asgjësimin e akteve shkresore të regjistrimit të pasurive të konfiskuara. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka tejkaluar shkakun e ankimit dhe nuk e ka arsyetuar disponimin e saj për konfiskimin e pasurisë.

14.8. *Së drejtës së pronës private*, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë interpretuar gabim nenin 190 të KPP-së. Sipas kësaj dispozite evidentohet qartë se sendet që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale ose që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga vepra penale konfiskohen dhe kalojnë në favor të shtetit, përveç kur provohet se ato u përkasin personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale. Nga të gjitha aktet e administruara provohet qartë se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së, Malësi e Madhe nuk është i falsifikuar, por edhe se pasuritë e disponuara me këtë akt janë në pronësi të personave të tretë. Po ashtu, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë bërë një interpretim të gabuar të rrethanave të faktit që rezultojnë nga hetimi gjyqësor. Në lidhje me pretendimin se vendimi i KKKP-së rezulton në emër të shtetasit Q.B., marrja në konsideratë e kësaj indicie nuk mjafton për të arritur në përfundimin se akti tjetër, në emër të shtetasit L.K., është i falsifikuar. Vendimet merrnin numërtimin e tyre sipas llojit të pasurisë që kthehej. Nuk është marrë parasysh as fakti se në vitin 2001 është vjedhur kasaforta e ish-kryetarit të KKKP-së, Malësi e Madhe. Gjithashtu, deklaratimet e kallëzuesve në vitin 2017 nuk ndryshojnë nga ato të dhëna në vitin 2007.

Prokuroria nuk ka kryer ekspertim grafik për të arritur në përfundimin se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së është i falsifikuar. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të hetimit nga prokuroria dhe gjykatat është bërë në mënyrë të gabuar, duke çuar kështu në një përfundim të gabuar në lidhje me fitimin e pronësisë së konfiskuar.

15. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

i. Për legjitimitimin

15.1. Kërkuesit Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar me anë të ankimit kushtetues.

ii. Për pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor

15.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i pabazuar, pasi në çështjen konkrete janë respektuar afatet e parashikuara nga ligji si për hetimin, ashtu edhe për gjykimin e saj. Procedimi penal është regjistruar në vitin 2017 dhe kërkesa për sekuestrimin e pronave është bërë në datën 23.5.2018, e cila është pranuar nga gjykata në datën 25.5.2018. Po ashtu, kërkesa për pushimin e procedimit penal është bërë në vitin 2019 dhe procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar në vitin 2024.

15.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, si dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi në rastin konkret nuk ndodhemi përpara gjësë së gjykuar. Në aspektin substancial vendimi ose urdhri i prokurorit që ka regjistruar procedimin penal rishtazi në vitin 2017, në mënyrë automatike ka shfuqizuar vendimin e pushimit të çështjes të vitit 2006. Në rastin konkret nga prokurori nuk është shfuqizuar një vendim gjykate i formës së prerë, çka do të përbënte gjë të gjykuar.

15.4. Edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv nuk është i bazuar, pasi siç edhe konstatohet nga vendimet gjyqësore, palët në procesin gjyqësor të kundërshtuar e kanë ushtruar të drejtën e tyre të ankimit, duke kundërshtuar vendimet e gjykatës më të ulët në atë më të lartë.

15.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private, pasi referuar jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), vendimet e gjykatave të cilat kanë pranuar kërkesën



për caktimin e masës së sekuestros së pasurisë kanë respektuar parimin e proporcionalitetit. Në rastin konkret hetimi është fokusuar tek ekzistenca e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”. Për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, konsiderohet se masa e sekuestros është e nevojshme, pasi është e aftë të sigurojë ndalimin e shitjes dhe transferimin e përfitimeve të persona të tretë, deri në përfundim të procesit penal. Masa e sekuestros është edhe e përshtatshme.

16. Subjektet e interesuara, Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar si vijon:

i. Për legjitimimin

16.1. Kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, për shkak se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.9.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 24.2.2025.

16.2. Kërkuesit Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për shkak se nuk kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

16.3. Po ashtu, kërkuesit nuk legjitimohen as *ratione materiae*, pasi pretendimet e tyre kanë të bëjnë me çmuarjen dhe vlefshmërinë e provave. Kërkuesit nuk kanë ngritur asnjë pretendim për shkelje të të drejtave kushtetuese.

ii. Për themelin e pretendimeve

16.4. Pretendimet e kërkuesve janë haptazi të pabazuara, pasi gjykatat e kanë gjykuar çështjen në përputhje me ligjin. Ato kanë qenë të paanshme dhe e kanë gjykuar çështjen brenda tagrave dhe kompetencës së tyre, bazuar në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm. Kërkuesve nuk u është cenuar as e drejta e aksesit, pasi të drejtat e tyre mund të mbroheshin në rrugë civile, të cilën ata nuk e kanë shfrytëzuar. Po ashtu, kërkuesve nuk u është cenuar as e drejta e ankimit, për shkak se ata e kanë ushtruar këtë drejtë, ndërkohë që një gjë e paligjshme nuk mund të mbrohet me ligj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

17. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individit mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 33, datë 20.5.2025; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesit Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar me anë të ankimit kushtetues individual. Kurse sipas subjekteve të tjera të interesuara, Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, kërkuesit Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, për shkak se nuk kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

20. Me qëllim sqarimin e rrethanave që lidhen pikërisht me legjitimimin *ratione personae* të kërkuesve, në datën 22.12.2025 Gjykata u ka kërkuar atyre të paraqesin argumente shtesë, si dhe



dokumente provuese. Këto argumente shtesë dhe dokumente provuese janë analizuar dhe vlerësuar në vijim nga Gjykata.

21. Kërkuesit Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja kanë parashtruar përpara Gjykatës se ata legjitimohen për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar dhe janë bartës të të drejtave themelore të cenuara nga procesi i kundërshtuar në këtë gjykim kushtetues.

22. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, vëren se në aspektin procedural palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues ka qenë vetëm kërkuesja Antonela Derza, ndërkohë që kërkuesit e tjerë Federik Derza, Gjergj Rreshpja dhe Violeta Rreshpja nuk kanë pasur cilësinë e palëve ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe as nuk rezulton të jenë thirrur nga gjykatat në asnjë shkallë të gjykimit.

23. Për sa i përket legjitimitit *ratione personae* të kërkuesve Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja në aspektin procedural dhe substancial të këtij kriteri, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

24. Sipas njërit qëndrim, edhe pse interesat e kërkuesve Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja preken nga vendimet e kundërshtuara me këtë ankim kushtetues, për sa kohë ato (vendimet gjyqësore të kundërshtuara) kanë disponuar për konfiskimin e pronës së tyre, këta kërkues nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi në aspektin procedural nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë gjykim në asnjë nga shkallët e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Në këtë pikëpamje, nëse këtyre kërkuesve u është cenuar ndonjë e drejtë kushtetuese substancial nga procesi gjyqësor i kundërshtuar, ata duhet të përdorin mjetet juridike në dispozicion dhe vetëm pas përdorimit të tyre t'i drejtohen Gjykatës, pasi mbrojtja kushtetuese ka natyrë subsidiare¹.

25. Sipas qëndrimit tjetër, kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja

legjitimohen *ratione personae*, pasi edhe pse nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë, ata legjitimohen si në aspektin substancial, ashtu edhe në atë procedural, për sa kohë që interesat e tyre preken nga vendimet e kundërshtuara me këtë ankim kushtetues, me të cilat është disponuar konfiskimi i pasurisë në pronësi të tyre dhe ata nuk janë njoftuar për asnjë nga proceset gjyqësore të zhvilluara për këto prona (procesi i sekuestrimit dhe ai i konfiskimit). Për këtë arsye, sipas gjyqtarëve të këtij qëndrimi, këta kërkues legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues individual².

26. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh në lidhje me plotësimin e kriterit të legjitimitit *ratione personae* për kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, pretendimet e tyre nuk mund të merren në shqyrtim. Për këtë arsye kërkesa e tyre konsiderohet e rrëzuar dhe nuk vijohet më tej me shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, në vijim do të vijohet me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitit vetëm për kërkuesen Antonela Derza.

27. Kërkuesja Antonela Derza, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës, ka argumentuar se ajo legjitimohet në kundërshtimin e vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues, pasi të drejtat e saj mbi pasurinë e konfiskuar burojnë për shkak të ligjit, si rrjedhojë e regjimit pasuror martesor të bashkësisë ligjore, duke qenë ajo bashkëshortja e kërkuesit Federik Derza, i cili pronën e ka blerë nga babai i saj në vitin 2012. Për të provuar këtë fakt, kërkuesja Antonela Derza ka paraqitur si provë edhe një certifikatë martese të datës 9.1.2026, sipas së cilës ajo rezulton e martuar me kërkuesin Federik Derza që nga viti 1995.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja Antonela Derza, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës plotëson kriterin e legjitimitit *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm që ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi, por ka arritur të provojë edhe

¹ Mbajtën këtë qëndrim gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini dhe Asim Vokshi.

² Mbajtën këtë qëndrim gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahim.



interesin e saj në drejtim të pasojave reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese të pretenduara të cenuara nga vendimet e kundërshtuara.

29. Në ankimin kushtetues është pretenduar edhe cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar, së drejtës së aksesit, së drejtës së ankimit efektiv dhe asaj për t'u njoftuar, si dhe parimit të kontradiktoritetit, me argumentin se i gjithë procesi hetimor dhe ai gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit është zhvilluar pa u thirrur asnjëherë personat në emër të të cilëve ishte pasuria, konkretisht kërkuesit Federik Derza, Gjovalin Rrepshja dhe Violeta Rrepshja. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në ç'mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese. Duke qenë se këto pretendime nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës kushtetuese të kërkueses për proces të rregullt, por synojnë mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, kërkuesja nuk legjitimohet për paraqitjen e tyre, për sa kohë nuk provon të drejtën e saj të cenuar dhe interesin vetjak për mbrojtjen e atyre të drejtave.

30. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se kërkuesja Antonela Derza formalisht i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata, bazuar

në aktet bashkëlidhur kërkesës, konstaton se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk është ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por është ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

32. Në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se procesi gjyqësor, që nga momenti i regjistrimit të procedimit penal e deri në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, ka zgjatur në tërësi rreth shtatë vjet. Për këtë arsye, ajo ka pretenduar se janë tejkaluar të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e kësaj çështjeje, çka ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së pronës.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja Antonela Derza i është drejtuar drejtpërdrejt asaj me ankim kushtetues individual, pa paraqitur më parë kërkesë në gjykatat e zakonshme, në përputhje me kompetencat e tyre dhe pa shfrytëzuar garancitë e mbrojtjes nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes. Për rrjedhojë, edhe në lidhje me këtë pretendim konsiderohet se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim. Kurse për sa u



përket pretendimeve të tjera të kërkuases për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, si dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së pronës, kërkuësja konsiderohet se ka shteruar mjetet e ankimit.

35. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, subjektet e interesuara, Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, kanë parashtruar se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.9.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 24.2.2025. Kërkuësja Antonela Derza ka parashtruar se e plotëson këtë kriter legjitimimi, pasi ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës, për shkak se vendimi i Kolegjit Penal i kundërshtuar është publikuar i arsyetuar 15 ditë përpara paraqitjes së ankimit kushtetues.

36. Gjykata vëren se kërkuësja Antonela Derza legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 12.9.2024, i cili, sipas shkresës nr. 729/1 prot., datë 18.2.2025, të Gjykatës së Lartë, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 27.12.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 21.2.2025, pra brenda afatit 4-mujor. Për rrjedhojë, pretendimi i subjekteve të interesuara, Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor është i pabazuar.

37. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuësja ka pretenduar cenimin e *parimit të pavarësisë* dhe *paanshmërisë*, si edhe *të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Sipas saj, rifillimi i hetimeve të procedimit penal nr. 1203 të vitit 2017 nga Prokuroria e Shkodrës, për të njëjtin fakt penal dhe për të njëjtat rrethana, është bërë në kundërshtim me nenin 329/c të KPP-së, si dhe ky rifillim është bërë mbi bazën e kallëzimit të subjekteve të interesuara, Gjergj Shtogaj, Age Shtogaj dhe Aleksandër Kocaj, për të njëjtin fakt për të cilin mbi kallëzimin e shtetasit Rr.Sh. kishte filluar në vitin 2006 procedimi penal nr. 781, i cili është pushuar në vitin 2007. Po sipas kërkuases, ky

procedim ka nisur pa asnjë provë ose të dhënë të re dhe ky fakt tregon se një veprim i tillë është në shkelje të hapur të nenit 329/c të KPP-së.

38. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si edhe të vlerësimit të provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime të kërkuases, bazuar në natyrën e argumenteve të parashtruara në mbështetje të tyre, Gjykata vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe rrethanave të çështjes konkrete, si dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit dhe si të tilla nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet që kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e së drejtës për proces të rregullt në aspektet e mësipërme, për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat e zakonshme në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

40. Kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, pasi, sipas saj, vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të hetimit nga prokuroria dhe nga gjykata e apelit është bërë në mënyrë të gabuar, duke çuar kështu edhe në një përfundim të gabuar në lidhje me fitimin e pronësisë së konfiskuar, e cila, ndryshe nga sa është konkluduar nga gjykatat, është fituar në mënyrë të ligjshme. Për rrjedhojë, sipas kërkuases, konfiskimi i pronës ka cenuar të drejtat kushtetuese të saj. Po sipas kërkuases, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë interpretuar gabim nenin 190 të KPP-së. Po ashtu, kërkuësja ka pretenduar se



nuk është marrë parasysh fakti se në vitin 2001 është vjedhur kasaforta e ish-kryetarit të KKKP-së, Malësi e Madhe dhe se deklarimet e kallëzuesve në vitin 2017 nuk ndryshojnë nga ato të dhëna në vitin 2007. Kërkuesja ka pretenduar se nga të gjitha aktet e administruara provohet qartë se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së, Malësi e Madhe nuk është i falsifikuar dhe se pasuritë e disponuara me këtë akt janë në pronësi të personave të tretë. Në përfundim, kërkuesja ka pretenduar se prokuroria nuk ka kryer eksperiment grafik për të arritur në përfundimin se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së është i falsifikuar. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, vlerëson se ato kanë të bëjnë në thelb me të drejtën e pronës private, e cila si një e drejtë me natyrë kushtetuese përfshihet në juridiksionin e kësaj Gjykate.

41. Kushtetuta, në nenin 41, pika 1, ka parashikuar se e drejta e pronës private është e garantuar. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni ka përcaktuar se prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se e drejta e pronës private, në çdo rast, shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në këtë kuptim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës të fituar në mënyrë të ligjshme, si dhe duke pasur parasysh faktin se gjatë procesit gjyqësor objekt i ankimit kushtetues është provuar plotësisht se vendimi nr. 38/2001 i KPPP-së, Malësi e Madhe, i cili është akti mbi të cilin është fituar pasuria nga shtetasi L.K., babai i kërkueses Antonela Derza, nga i cili ka buruar titulli i pronësisë së vet kërkueses dhe mbi të cilin ajo ka mbështetur pretendimet për mbrojtjen e së drejtës së pronës, është i falsifikuar. Gjykata vlerëson që t'i analizojë pretendimet e saj në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

43. Kërkuesja ka pretenduar se prona e cila është konfiskuar është fituar në mënyrë të ligjshme, duke qenë se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së nuk është

i falsifikuar. Sipas kërkueses, vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të hetimit nga prokuroria dhe gjykata e apelit është bërë në mënyrë të gabuar. Për këtë arsye, sipas kërkueses, nga gjykata e apelit është arritur në një përfundim të gabuar në lidhje me fitimin e pronësisë së konfiskuar, e cila tashmë u ka kaluar personave të tretë. Për rrjedhojë, kërkuesja ka pretenduar se konfiskimi i pronës ka cenuar të drejtat kushtetuese të saj dhe se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në arsyetimin e vendimeve të tyre kanë interpretuar gabim nenin 190 të KPP-së.

44. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi, referuar jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, vendimet e gjykatave, të cilat kanë pranuar kërkesën për caktimin e masës së sekuestros së pasurisë, kanë respektuar parimin e proporcionalitetit. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, në rastin konkret hetimi është fokusuar tek ekzistenca e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së dhe për shkak të natyrës së kësaj veprë penale, konsiderohet se masa e sekuestros është e nevojshme, pasi është e aftë të sigurojë ndalimin e shitjes dhe transferimin e përfitimeve të persona të tretë, deri në përfundim të procesit penal.

45. Sipas subjekteve të interesuara Gjergj Shtogaj dhe Age Shtogaj, pretendimet e kërkueses janë haptazi të pabazuara, pasi gjykatat e kanë gjykuar çështjen në përputhje me ligjin, duke qenë të paanshme dhe duke e gjykuar atë brenda tagrave dhe kompetencës së tyre, bazuar në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm. Sipas këtyre subjekteve, kërkueses nuk i është cenuar as e drejta e aksesit, pasi të drejtat e saj mund të mbroheshin në rrugë civile, të cilën ajo nuk e ka shfrytëzuar.

46. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, Gjykata ka theksuar se ajo përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë që ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka



qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të ndalet në arsyetimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me qëllimin për të vlerësuar nëse arsyetimi i tyre rezulton arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm apo nëse ato përmbajnë gabime të tilla që mund të prishin drejtësinë e procesit dhe që një gjykatë e kujdesshme nuk mund t'i kishte bërë.

49. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se Prokuroria e Shkodrës, pas regjistrimit të procedimit në ngarkim të shtetasit L.K., ka paraqitur një kërkesë për vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë e përfuara prej tij, mbi bazën e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me arsyetimin se ajo është e bazuar në ligj dhe përputhet me qëllimin e përcaktimeve të KPP-së (*shih paragrafin 4 të këtij vendimi*). Po ashtu, Gjykata vëren se në përfundim të hetimeve penale të procedimit penal në ngarkim të shtetasit L.K., Prokuroria e Shkodrës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 1203 të vitit 2017, për shkak se vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i KP-së ishte parashikuar, kurse për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndjekja penale nuk mund të vazhdonte më, për shkak se kishte ndërruar jetë personi i dyshuar për kryerjen e saj. Prokuroria e Shkodrës në kërkesën e saj i ka kërkuar gjykatës edhe konfiskimin e disa pasurive të paluajtshme të përfuara në bazë të vendimit nr. 38/2001 të KPPP-së, Malësi e Madhe, për të cilin është arritur në konkluzionin se ishte i falsifikuar, shkak për të cilin

është kërkuar edhe asgjësimi i tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka marrë në shqyrtim këtë çështje, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesës vetëm për sa i përket pushimit të çështjes penale, ndërkohë që ka rrëzuar pjesën tjetër të kërkesës për konfiskimin e pasurive të paluajtshme dhe asgjësimin e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe (*shih faqen 20 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

50. Mbi ankimin e Prokurorisë së Shkodrës, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur pranimin e plotë të kërkesës së saj, duke vendosur edhe konfiskimin e pasurive të paluajtshme nr. 221/4, 700 m², livadh, e regjistruar në datën 19.2.2015 në emër të Gjovalin Rrepshjes dhe Violeta Rrepshjes; nr. 221/5, 8800 m², livadh dhe nr. 221/6, 500 m² livadh, të regjistruara në datën 19.2.2015 në emër të Federik Prel Derzës, të cilat ndodhen në ZK nr. 3834 në fshatin Vrith, njësia administrative Shkrel, Malësi e Madhe, si dhe asgjësimin e dokumentit vendim nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe. Sipas gjykatës së apelit, falsiteti tërësor i vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe provohet nga deklaratimet e shtetasve në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, konkretisht shtetasve C.Gj. (me detyrën e nënkryetarit të atij organi në periudhën përkatëse), F.K. dhe R.H. (me detyrë në periudhën përkatëse pranë atij organi), sipas të cilëve ky vendim është i falsifikuar si nga ana formale, ashtu edhe thelbësore, si dhe nga shkresat kthim përgjigje të institucioneve zyrtare, praktikat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në ZVRPP, kontratat e shitblerjes dhe dokumentet e ZVRPP-së për ndarjen e pasurive të paluajtshme. Për këto arsye, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se vendimi nr. 38/2001 i KKKP-së, Malësi e Madhe rezulton i falsifikuar në aspektin material, pasi provohet se është i falsifikuar në përmbajtje, për shkak se përmban të dhëna të rreme, si dhe në aspektin formal, për shkak se në përmbajtjen e tij nuk janë të gjithë anëtarët e asaj kohe të komisionit. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka vlerësuar se ndodhet përpara deklaratimit në dispozitiv të falsitetit të dokumentit të mësipërm dhe urdhërimit të fshirjes tërësore të tij, disponim që bëhet nga gjykata edhe në rastin e marrjes së vendimit të pushimit të procedimit penal, përcaktim ky që parashikohet në nenin 391 të KPP-së të analizuar në tërësi me nenin 190 të KPP-së, për sa kohë që me provat e administruara është provuar falsiteti i vendimit të



KKKP-së, Malësi e Madhe gjatë hetimit dhe çështja është pushuar për një shkak tjetër, në rastin konkret për shkak të afateve të parashkrimit dhe vdekjes së personit të dyshuar (*shih faqet 12–13 të vendimit të gjykatës së apelit*).

51. Mbi rekursin e kërkuësës, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, deklarimi i falsitetit të aktit është bërë nga gjyqtari i seancës paraprake, referuar neneve 391 dhe 190, pika 1, të KPP-së. Në vlerësimin e Kolegjit Penal neni 190 i KPP-së parashikon se disponimi për provat materiale bëhet ose nga gjykata e themelit në vendimin përfundimtar ose nga prokuroria në vendimin e pushimit. Për këtë arsye, Kolegji Penal ka arsyetuar se në rastin e pushimeve të procedimeve për krime, ku prokuroria paraqet kërkesë në gjykatë për pushimin e procedimit penal, kompetenca për të disponuar për provat materiale, si rrjedhim edhe deklarimi i një akti të falsifikuar (shkronja “b” e pikës 1 të nenit 190 të KPP-së) i takon gjyqtarit të seancës paraprake. Sipas atij kolegji, në rastin konkret, vendimmarrja e gjykatës së apelit për ndryshimin e disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me asgjësimin e dokumentit të falsifikuar, si dhe konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të pronave/pasurive të përfituara mbi një akt të falsifikuar, është e drejtë dhe e bazuar në nenet 391 dhe 190 të KPP-së. Në këtë kuptim, Kolegji Penal ka vlerësuar se është në kompetencën e gjyqtarit të seancës paraprake që krahas pushimit të çështjes penale, të disponojë edhe për deklarimin e falsitetit të dokumentit dhe asgjësimin e tij, kur një fakt i tillë rezulton qartazi dhe nuk kontestohet nga palët pjesëmarrëse. Po sipas Kolegjit Penal, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, brenda kufijve të shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake (*shih faqet 11–14 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

52. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren fillimisht se nuk rezultojnë gabime të dukshme faktike apo ligjore në arsyetimin e vendimeve të gjykatave kur kanë vlerësuar falsitetin vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe, si dhe kur kanë arritur në përfundimin se ishin të zbatueshme dispozitat procedurale për konfiskimin e sendeve të sekuestruara. Po ashtu, Gjykata konstaton se falsiteti i vendimit nr. 38/2001 të

KKKP-së, Malësi e Madhe është konstatuar nga gjykata e apelit pas një procesi vlerësimi tërësor të provave dhe rrethanave të rastit konkret, të administruara në atë proces gjyqësor. Në këtë rast, gjykata e apelit ka analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e faktit dhe zbatimi i ligjit prej saj në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete jo vetëm që nuk rezulton të jetë arbitrar ose i paarsyeshëm, në kuptimin e gabimeve ligjore, por ajo gjykatë, në mënyrë të plotë, ka parashtruar në vendimin e saj të gjitha argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv. Edhe Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, në interpretimin e normave ligjore të zbatueshme në rastin konkret, neneve 190 dhe 391 të KPP-së, ka arritur në përfundimin se në rastet e pushimeve të procedimeve për krime, ku prokuroria paraqet kërkesë në gjykatë për pushimin e procedimit penal, kompetenca për të disponuar për provat materiale, si rrjedhim edhe deklarimi i një akti të falsifikuar i takon gjyqtarit të seancës paraprake.

53. Gjatë gjyimit në gjykatat e zakonshme është provuar tërësisht se vendimi nr. 38/2001 i KPPP-së, Malësi e Madhe, që është akti mbi të cilin është fituar pasuria nga shtetasi L.K., babai i kërkuësës Antonela Derza, është i falsifikuar. Në këto kushte, gjykatat e zakonshme, në interpretim dhe zbatim të neneve 190 ose 391 të KPP-së, që parashikojnë mënyrën e disponimit për provat materiale, kanë deklaruar falsitetin e dokumentit dhe kanë disponuar asgjësimin e tij, duke arsyetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese vendimmarrjen e tyre.

54. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit Shkodër dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimet e kërkuësës në këtë drejtim janë të pabazuara.

55. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës Antonela Derza për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

56. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se edhe kërkesa e paraqitur nga kërkuësja për pezullimin e veprimeve përbarimore ose administrative për pasurinë e konfiskuar, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar prej saj, është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.3.2026.

Shpallur më 28.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkuar Antonela Derza, Federik Derza, Violeta Derza dhe Gjovalin Rreshpja, me objekt “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 529 (2595), datë 25.5.2018, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 1482 (4042), datë 29.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 282, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-1437, datë 12.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*”, ne, gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar pjesërisht, duke u vendosur shfuqizimi i vendimeve të kundërshtuara të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

2. Fillimisht, në lidhje me plotësimin e kushteve të legjitimit të kërkuarve, ashtu siç kemi mbajtur edhe qëndrimin e shprehur në këtë vendim, vlerësojmë se kërkuarët Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja legjitimohen *ratione personae*, pasi edhe pse nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë,

ata legjitimohen si në aspektin substancial, ashtu edhe atë procedural, për sa kohë që interesat e tyre preken nga vendimet e kundërshtuara me këtë ankim kushtetues, me të cilat është disponuar konfiskimi i pasurisë në pronësi të tyre dhe ata nuk janë njoftuar për asnjë nga proceset gjyqësore të zhvilluara për këto prona (procesi i sekuestrimit dhe ai i konfiskimit) (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

3. Po ashtu, këta kërkuar plotësojnë edhe kriterin tjetër të legjitimit, atë të *shërimit të mjeteve juridike efektive*, pasi edhe pse nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në ankimin kushtetues individual kanë argumentuar se nuk kishin mjete juridike efektive në dispozicion për të kundërshtuar konfiskimin e disponuar me vendimin e gjykatës së apelit.

4. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Prokuroria e Shkodrës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 1203 të vitit 2017 të regjistruar ndaj shtetasit L.K., duke kërkuar, gjithashtu, konfiskimin e disa pasurive të paluajtshme të përfituara prej tij (shtetasit L.K.) në bazë të vendimit nr. 38/2001 të KPPP-së, Malësi e Madhe, për të cilin është arritur në konkluzionin se ishte i falsifikuar, shkak për të cilin është kërkuar edhe asgjësimi i tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pranimin e pjesës së kërkesës vetëm për sa i përket pushimit të çështjes penale, ndërkohë që ka rrëzuar pjesën tjetër të kërkesës për konfiskimin e pasurive të paluajtshme dhe asgjësimin e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe. Mbi ankimin e Prokurorisë së Shkodrës, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur pranimin e plotë të kërkesës së saj, duke vendosur edhe konfiskimin e pasurive të paluajtshme, me arsyetimin se ndodhej përpara deklarimit në dispozitiv të falsitetit të vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së, Malësi e Madhe. Ajo gjykatë ka urdhëruar edhe fshirjen tërësore të këtij akti, disponim që bëhet edhe në rastin e marrjes së vendimit të pushimit të procedimit penal, sipas nenit 391 të KPP-së të analizuar në tërësi me nenin 190 të KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarja Antonela Derza, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, vendimmarrja e gjykatës së apelit për ndryshimin e disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me asgjësimin e dokumentit të falsifikuar dhe konfiskimin e kalimin në favor të



shtetit të pronave/pasurive të përfituara mbi këtë akt të falsifikuar është e drejtë dhe e bazuar në nenet 391 dhe 190 të KPP-së.

5. Ky disponim i gjykatave është kundërshtuar nga kërkuesit nëpërmjet ankimit kushtetues individual, duke argumentuar, ndër të tjera, se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave nga prokuroria dhe gjykata e apelit është bërë në mënyrë të gabuar, duke u arritur në një përfundim të gabuar në lidhje me fitimin e pronësisë së konfiskuar, e cila që në vitet 2012 dhe 2015, pra përpara fillimit të procesit gjyqësor të kundërshtuar, u ka kaluar personave të tretë, konkretisht kërkuesve Federik Derza, Gjovalin Rreshpja dhe Violeta Rreshpja. Për rrjedhojë, sipas kërkuesve, konfiskimi i pronës në mungesë totale të njoftimit të tyre si për procedurat e sekuestros, ashtu dhe për procesin e konfiskimit, ka cenuar të drejtat e tyre kushtetuese, ndaj dhe interpretimi i nenit 190 të KPP-së nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë është arbitrar.

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me këtë standard kushtetues, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Sipas nenit 190, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale, duke urdhëruar që sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, të merren dhe t'i kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e

veprës penale. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se është e lejuar të konfiskohen vetëm ato sende që i përkasin autorëve të kryerjes së veprës penale dhe jo sendet që u përkasin personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e saj.

8. Në rastin konkret, ashtu siç edhe është konstatuar nga rrethanat e çështjes, personi ndaj të cilit është regjistruar procedimi penal, i cili më pas është pushuar, ka qenë shtetasi L.K. Po ashtu, ka rezultuar se pronat të cilat janë konfiskuar nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, janë shitur fillimisht nga shtetasi L.K. te kërkuesi Federik Derza (në vitin 2012) dhe, më pas, nga ky i fundit te kërkuesit e tjerë Gjovalin Repshja dhe Violeta Repshja (në vitin 2015) është shitur një sipërfaqe toke 700 m². Kështu, rezulton se pronat e konfiskuara nga gjykatat nuk janë prona të cilat i përkasin personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale, të cilat mund të konfiskohen, sipas nenit 190 të KPP-së, por u përkasin personave të tjerë, të cilët nuk rezultojnë se kanë marrë pjesë dhe madje as kanë qenë të dyshuar për kryerjen e veprave penale, për të cilat është regjistruar procedimi penal nga Prokuroria e Shkodrës. Gjithashtu, rezulton se edhe pse pronat e konfiskuara nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë të pronësi të kërkuesve Federik Derza, Gjovalin Repshja dhe Violeta Repshja, ata nuk janë njoftuar dhe nuk janë bërë pjesë e atij procesi gjyqësor.

9. Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj (Gjykatës) është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 48, datë 22.9.2025; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 63, datë 23.10.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto raste, për të mos vënë në dyshim të drejtën e gjykatave të



zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, Gjykata kufizohet vetëm në identifikimin e gabimeve të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit dhe që cenojnë gjykimin e drejtë (*shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më lart, në vlerësimin tonë shumica duhej të ndalej në mënyrën sesi është interpretuar dhe zbatuar neni 190 i KPP-së nga gjykata e apelit që ka shqyrtuar kërkesën për konfiskimin e pasurive të paluajtshme dhe asgjësimin e vendimit nr. 38/2001 të KKKP-së Malësi e Madhe. Kjo çështje merr veçanërisht rëndësi, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor i konfiskimit të pasurive është bërë në mungesë dhe pronarët (kërkuesit) nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese.

11. Në vlerësimin tonë, për shkak të natyrës së procesit gjyqësor në tërësinë e tij, gjykata e apelit nuk duhej të mbante një qasje të tillë formaliste, por duhej të ushtronte funksionin e saj kushtetues dhe ligjor, duke synuar të drejtën. Gjykatat e zakonshme kanë detyrimin që interpretimi që u bëjnë dispozitave ligjore gjatë zbatimit të tyre të shkojë drejt mbrojtjes të të drejtave të individit, veçanërisht atij që është duke u gjykuar në mungesë dhe nuk ka pasur asnjë mundësi të mbrohet ose të parashtrrojë qëndrimin e tij për mbrojtjen e të drejtave substanciale kushtetuese, siç është ajo e pronës private. Të tilla qëndrime të gjykatave të zakonshme kthehen në kufizuese të të drejtave të individit dhe vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor.

12. Kjo çështje dhe dinamikat e saj nuk janë analizuar dhe as vlerësuar me objektivitet nga gjykata e apelit, duke bërë që arsyetimi i saj formalisht të mbështetet vetëm në parashikimet ligjore, pa marrë në konsideratë rrethanat dhe faktet e çështjes, për më tepër që pronat të cilat janë konfiskuar janë në pronësi të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, siç kërkon neni 190, pika 1, shkronja “a”, i KPP-së. Në këtë kontekst, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së gjykatës së apelit rezulton të jetë formaliste dhe jokohërente në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese. Thënë kjo, interpretimit të ligjit nga gjykata e apelit, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit, duke e bërë atë formalist dhe arbitrar. Parë në këtë këndvështrim, kërkesa duhej

pranuar dhe Gjykata duhet të dispononte për shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit.

13. Duke pasur parasysh qëndrimin e gjykatave të zakonshme, si dhe pretendimin me natyrë kushtetuese të kërkuesve që lidhej me interpretimin e nenit 190 të KPP-së, në kuptim të pozicionit e funksionit të saj sipas nenit 141 të Kushtetutës, i takonte Gjykatës së Lartë që t'i jepte një interpretim të drejtë normës ligjore në kuptim të zbatimit të saj, në rastin konkret në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në përfundim, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se interpretimi që gjykatat e zakonshme (gykata e apelit dhe Gjykata e Lartë) i kanë bërë nenit 190 të KPP-së duket i paarsyeshëm dhe arbitrar. Për pasojë, çmojmë se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, ndaj Gjykata duhej të vendoste pranimin pjesërisht të kërkesës dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e vendimeve nr. 282, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2024-1437, datë 12.9.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe dërgimin e kësaj çështjeje për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja

KËRKESË

Nr. 190/12, datë 28.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i Urës së fshatit Metoq’”, Bashkia Sarandë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Sarandë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur



për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 49,256 (dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË								Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa e pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqja e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (m ²)		
1	Ibrahim Çuni			Metoq	2677	101/115	Arë	1788	524.0	94	49,256	49,256	
2	Shitet			Metoq	2677	1190	Arë		525.4	0	0		
TOTALI												49,256	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

